

Nashifere Mëhalla Brooker

SIGURIMI I SHTETIT - ARMA PËR MBROJTJEN E “REVOLUCIONIT KOMUNIST”

Abstrakt

Lufta partizane u vlerësua si fitore politike dhe sociale e udhëhequr nga Partia Komuniste (PK). Eshtë tashmë e dokumentuar nga librat e Enver Hoxhës, komunikata dhe raporte të PK se çfarë do të ndodhte me këdo që mendonte ndryshe. Udhëzimet ishin të qarta. Seksione të caktuara të PK përfshiheshin dhe forcave partizane në askione asgjësuese të të dyshuarve. Sigurimi ishte arma e vetme në duartë e partisë. Imagjinat apo anti-komunist të vërtetë nuk do toleroheshin. Tolerimi i zërave ndryshe për Sigurimin dhe partinë ishte rikthim në rendin e vjetër feudalo-borgjezë. Prandaj, partia, gëzonte automatikisht të drejtën ligjore dhe morale të përndiqte cdo opinion ndryshe. Thellimi i luftës së klasave do vazhdonte me cdo cmim. Klasat e përmbysura duhej të asgjësoheshin me cdo kusht. Ekzistenca e tyre përbënte rrezik për vetë PK. Dhe kjo detyrë, ishte “sakrificë” sepse partia do mbronte popullin nga regjimi regjimi i kaluar. Si rrjedhojë, Sigurimi kërkonte besnikërinë e popullit. Shpërblimi i popullit ndaj Sigurimit do ishte; denoncimin tek ata për

këdo që nuk ishte i kënaqur me ndryshimet politike, ekonomike, mungesa ushqimesh, rebelime me armë, dhe cdo veprim tjetër i perceptuar si anti-parti. Prandaj Sigurimi perceptohej si organizata e herojve. Cdo ditë ata do luftonin si me eliminimet fizike dhe asgjësimin e mendimit të lirë. Nëse mendimet e lira konsideroheshin ndryshe, duheshin mbytur me forcë. PK qartësoj që në fillim se nuk ishte partia e pranimit të opinionit të popullit. Ky pushtet i plotë i Sigurimit ishte i “shenjtë”. Kjo shenjtëri krijoi rreth vetes një kordon që zotëronte të drejtën e përhershme të pafajsisë dhe pa ndëshkueshmërisë. Pra, autoritetet shtetërore si ai i Sigurimit, asnjëherë nuk do deklaroheshin fajtorë edhe për gjënë më të vogël. Ata i shërbyen partisë duke pasur pushtet absolute mbi popullin.

Nëpërmjet këtij shkrimi do të shpjegoj qëllimin e këtij hulumtimi ku fokusi është; terrori shtetëror komunist i organeve represive i Sigurimit të Shtetit. Njohja me historinë e tij është e rëndësishme për gjithkënd që do të kuptoj padrejtësitë e së shkuarës komuniste. Tashmë kemi parë se vendet e kujtesës po bëhen çdo ditë e më të njohura. Një nga këto vende është edhe muzeumi i survejimit të *Sigurimit*¹²⁰, “*Shtëpia e Gjetheve*¹²¹” ose “*House of Leaves*” në anglisht. Sapo futesh në të ndjen forcën e një shteti represiv dhe opresiv ku çdo dhomë ka

¹²⁰ [Sigurimi police organization, Albania | Britannica](#)
¹²¹ [Historia e “Shtëpisë me Gjethe” \(shekulli.com.al\)](#)

mjetet survejuese të ekspozuara. Vetëm kur jemi aty kuptojmë se çdo informacion i këtyre mjeteve filtërohej, dhe transmetimi, ekzaminimi ishte fatale për njerëzit që survejoheshin. E pamundur të distancosh dhimbjet njerëzore, shkaktuar nga këto mjete me ngjyra “makabër”. Nga ana tjetër aty vëren teknologjinë e avancuar të kohës. Por, fatkeqsisht ky zhvillim i teknologjisë i shërbeu pushtetit komunist për të skllavëruar popullin.

Në tetor të vitit 2020, Xhejms Barthelemeo (James Bartholomeo) vjenë në Shqipëri për vizitë në vendet e kujtesës. Ai është gazetar i njohur anglez, autor librash dhe drejtor i Muzeumit Totalitar në Londër¹²². Përveç vizitës në *Spaç*¹²³, *Kampin e Tepelenës*¹²⁴, viziton edhe *Shtëpinë e Gjethëve*. Papritur, si në një ditë të zymtë dimri, në këtë ndërtesë ku gatuhej djalli vetë për gjysëm shekulli, në koridoret e muzeumit ndeshëm buzëqeshjen e drejtoreshës Etleva Demollari. Buzëqeshja e saj vijoj me një bisedë sa miqësore aq edhe profesionale, rreth muzeumit në përgjithësi e vazhdoj më tej me diskutime për bashkëpunime në të ardhmen. Kjo vizitë, më dha shkas të hulumtoj më thellë ndryshimet masive sociale, dhe politike të Shqipërisë gjatë diktaturës siç do shohim në këtë shkrim më poshtë.

Personalisht kujtoj shprehje të tilla në vitet e shkollës si “*punonjës i Sigurimit*”, “*njërëz të lidhur me partinë*”,

3The Spectator columnists & writers

4Kamp-burgu i Spaçit - Harta e Kujteses

¹²⁴Kampi i Tepelenës - Harta e Kujteses

“*organet e larta të Sigurimit*”, dhe “*gazi i Sigurimit*”. Këto shprehje i dëgjoje nga njerëzit e frikësuar prej Sigurimit, por, nga ana tjetër, kush ishte i lidhur me të, kishte krenari të madhe. Duhet theksuar ajo që ndarja sociale ishte si e prerë me thikë për “arsye politike”, ajo midis “*familjeve me përbërje të keqe*” “armiku i popullit” me ato me “*përbërje të mirë*, pra të lidhur me partinë. Frazja të kësaj natyre na ftojnë të mësojmë të vërtetën, jo vetëm të familjeve të viktimave të kohës, femijëve, nipërve dhe mbesave të tyre, por edhe të atyre të cilët ishin pjesëmarrës aktiv i represionit komunist.

Vlen këtu të sjell një shembull për ndryshimet sociale. Një nga këto ishte ajo e informatorëve të Sigurimit. Ata/ato përdornin shpesh marrëdhëniet familjare, farefisnore, dhe çdo njohje të afërt të komunitetit ku jetonim për informim kundër kujtdo. Sot kur analizon këtë metodë pune, na tregon se paralelisht jetonin si informatorëve si dhe viktimat. Rëndësi meritojnë statistikat e Arkivit të MB. Në vitin 1949 kemi 9141 informator, e cila rritet deri me 1965, dhe kemi ulje , ngritje deri me 1990-ën. Po ashtu vetëm brenda 8 vjetësh 1973-81 numuri i agjentëve nga Sigurimi shkon nga 17,787 në 65.383 në 1981. Kategoria e agjentëve vjen nga të gjitha klasat. Por, vecohet klasa e mesme ku numri është më i lartë.

Sjell këtu një fakt personal që më ndodhi kur isha 15 vjeçe. Dy djem që shpesh bënë rrugën bashkë për në shkollë të mesme, më raportuan tek drejtori i shkollës.

Akuzohesha se kisha bërë komente mbi Enver Hoxhën. Këta dy djem, miq të vjetër të familjes, dikujt i raportuan komentin tim më parë se sa e raportuan në shkollë. Pra, një rrjet i tërë njerëzish ishin vënë në djepin.

Një historik i shkurtër i Shërbimit Informativ Komunist (SHIK)

Në këtë shkrim do shtjelloj me pak fjalë krijimin e parardhësve të Sigurimit siç do vijoj më poshtë. E para strukturë duhet të jëtë krijuar në vitin 1943 dhe mbante emrin *SHIK*. Kjo forcë pastaj u konsolidua pas lufte dhe mori emrin *Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit* (DMP), dhe më së fundi *Sigurimi*. Për faktin se sot kemi data fiktive për krijimin e SHIK-ut të urdhëruara me urdhër “nga lartë” edhe kjo datë vihet në diskutim. Le të shohim se çfarë sjellë për ne autori Kastriot Dervishi, dhe se si u caktua kjo datë nga vetë Hoxha. Ai vetëm kur ishte në pozicionin e tij të pushtetshëm mundej të ndryshonte, apo sajonte histori. Dervishi shkruan: “*Sekretariati i KQ te PPSH-së,..... datë 5 qershor 1962, vendosi që 20 marsi 1943 të ishte dita përkujtimore e themelimit të armës së Sigurimit të shtetit*¹²⁵”. Kurse vendimi i Presidiumit të Kuvendit Popullor i datës 14 dhjetor 1962 thotë tekstualisht kështu: “*Duke marrë parasysh se data 20 mars 1943, dita e krijimit të armës së Sigurimit të Shtetit, shënon një ngjarje me rëndësi në historinë e luftës së popullit tonë nën*

¹²⁵ Kastriot Dervishi, *Sigurimi i Shtetit 1944-1991*, 2012, fq 12.

*udhëheqjen e partisë për çlirimin e atdheut dhe për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit socialist*¹²⁶. Kurse vetë *Sigurimi*, më 1973, kur kishte krijuar kultin e vetë, feston 30 vjetorin e krijimit të tij me revistën *Në Shërbim të Popullit*. Pra, njeh si vitin e themelimit vitin 1943.

Nëse ishte dikë që kishte njohuri mbi aktivitetet represive të SHIK-ut gjatë luftës ishte vetë dhe vetëm Hoxha. Gjuha e përdorur në vendimin e Kuvendit Popullor të vitit 1962 është e njëjta gjuhë e represionit ushtruar nga SHIK-u, krijuar në mënyrë formale gjatë luftës. Armata e Sigurimit të shtetit, nga vetë emri “armata, armës” tregon natyrën violente. Mund të përmendim këtu një nga vrasjet e fraksioneve brenda lëvizjes komuniste, atë të Anastas Lulos¹²⁷, e cila përkon po me këtë periudhë. Vrasja e tij ka ndodhur në mars ose prill me urdhër të Hoxhës. Ai u pushkatua nga njësi partizane, sepse akuzohej të ishte pjesë e grupit të Xhelal Staraveckës¹²⁸.

Faza e dytë, është krijimi i *Drejtorisë për Mbrojtjen e Popullit*¹²⁹ (DMP) në vitin 1945 e formuar menjëherë pas lufte. DMP-ja i krijua si kundërforcë për shtypjen e rezistencës anti-komuniste¹³⁰. Megjithatë, nga shënimet e

¹²⁶ Po aty fq, 12-13.

¹²⁷ PARTIA KOMUNISTE SHQIPTARE NEN PESHEN E KRIMIT TE VET – Dielli | The Sun (gazetadielli.com)

¹²⁸ Enver Hoxha, Blendi Fevziu, (English copy) Pg.48

¹²⁹ Historiku i Ministrisë së Brendshme - Ministria e Brendshme (mb.gov.al)

¹³⁰ Albania and Balkans, essay by Michael Schmidt Neke, fq.119

Vaskë Kolecit¹³¹, letër e botuar nga Kastriot Dervishi, na rezulton se DMP-ja është themeluar më 10 dhjetor të vitit 1944¹³². E njëjta datë është për formimin e *Sigurimit* në faqen e Ëikipedia-s¹³³.

Pas lufte kemi atë që nën drejtimin e Haxhi Lleshit, DMP-ja kishte 5000 burra pa uniformë. Kjo armatë ishin personat që kishin dhëne besnikërinë e tyre ndaj lëvizjës komuniste gjatë luftës, nën komandën e Ministrit të Brendshëm. Sigurimit arriti të kishte 30.000 personel në 1989-ën, ku 7500 persona nga kjo shifër ishte integruar në ushtri. Duhet theksuar se emri i personit në që ishte shefi i Sigurimit nuk publikohej për publikun. Emri i tij (kryesisht burra mbajtën këtë rol), dihej vetëm nga persona që e kishin mësuar gojarisht. Publiku nuk kishte mundësi të njihej me punën e shërbimit sekret.

Kushtet e krijimit të SHIK-ut gjatë luftës

Pranvera e vitit 1943 e gjeti Shqipërinë nën zjarrin e grupimeve politike të ndryshme. *Partia Komuniste Shqiptare* (PKSH, PK), tashmë ishte disi e konsoliduar si forcë politike pavarësisht se ishte tepër e re si grupim. Vetë Hoxha emërohet sekretar politik i PK më 18 Mars¹³⁴ të 43-shit. Njësit partizane ishin të njëjsuara me lëvizjen

¹³¹ [Vaskë Koleci - kujto.al](http://VaskëKoleci-kujto.al) | [Online Archive of Victims of communism in Albania](http://OnlineArchiveofVictimsofCommunism.inAlbania)

¹³² [Dervishi: Organet e Sigurimit të Shtetit u krijuan më 1944, por ja c'vendosi Kuvendi Popullor \(panorama.com.al\)](http://Dervishi:OrganetESigurimitteshtetitukrijuanme1944.porjacevendosiKuvendiPopullor(panorama.com.al))

¹³³ [Sigurimi - Wikipedia](http://Sigurimi-Wikipedia)

¹³⁴ Enver Hoxha, Blendi Fevziu, fq. 75

komuniste. Hoxha personalisht mori mbështetjen e plotë të jugosllavëve, si dhe shumë komunistëve në vend. Dushan Mugosha dhe Miladin Popoçivi¹³⁵ ishin *de facto* krijuesit e PK dhe mbështetës të Hoxhës gjatë gjithë periudhës së luftës. Ata panë tek Hoxha një përsôn i cili do zbatonte vijën e tyre politike si përfaqësuesë të *Partisë Komuniste Jugosllave* (PKJ). Ishin edhe dy grupimet e tjera e Ballit Kombëtar¹³⁶ dhe Lëvizja Legaliste¹³⁷, të cilat ishin për luftë kundër okupatorit. Të dyja keto grupime politike ishin antikomuniste. Prania e jugosllavëve në çdo hap të politikbërjes së Hoxhës i dha atij marjen e strategjisë së gatshme të Titos për pushtetmarrje. Një nga këto strategji ishte përqëndrim total në eliminimin e rivalëve politikë. Tito vetë gjatë luftës dhe deri në ndarjen me Stalinin ishte stalinist. Hoxha nëpërmjet Titos përfitoj edhe për lidhjen direkte me Stalinin. Përfundimisht stalinizmi ishte “rruga drejt stabilitetit” për Hoxhën deri në ditën e vdekjes së tij.

Pra, jugosllavët i dhanë Hoxhës mundësinë të ishte në krye të PK, plus u shpall komandant i forcave partizane, plus i dhanë atij strategjinë Titiste të gatshme. Këto mundësi i dhanë atij pushtetin politik pas lufte dhe ndërtimin një parti-shtet në vend, pra diktaturën.

¹³⁵ Fillimet e diktaturës komuniste në Shqipëri, 2013, Celo Hixha, ISKK, fq. 20

¹³⁶ Balli Kombëtar Demokrat - PARTI E SHQIPTARIZMIT - LIDHJA E PRIZRENIT (ballikombetar.info)

¹³⁷ Ekrem Spahiu: Pse u krijua Legaliteti, 77 vite më parë?! (shekulli.com.al)

Lufta civile gjatë 43-44

Si fillim le të njihemi me disa informacione rreth situatës në Jugosllavi që të kuptojmë se çfarë ka ndodhur në Shqipëri. Në vitin 1941, në Qershor, lëvizja partizane jugosllave, luftonte në male, e udhëhequr nga Tito. Kjo ishte rezistenca kundër okupatorit gjermanë. Çetnikët nga ana tjetër, përkrahës të Mbretit Piter, po ashtu i rezistuan gjermanëve si fillim. Situata ndryshoj kur qeveria Britanike njohu qeverinë e mbretit Piter në Londër. Si rrjedhojë Titos ju shtuan dyshimet për Çetnikët. Dhe ky u bë shkaku i fillimit të luftës civile në Jugosllavi në pranverën e vitit 1942. Tito atëherë filloj të godas klasat e vjetra “armike”. Goditjet ishin likuidime fizike, ku kishte caktim kuotash për ekzekutime dhënë këto çdo njësie partizane. Këto udhëzime jepeshin nga anëtarë të KQ të PKJ, përfshi këtu edhe Milovan Djilas¹³⁸.

Djilas¹³⁹ njëri më i afërt i Titos e përshkruan kështu luftën civile: *“Me orë të tëra të dyja forcat luftuese ngjiteshin nëpër rrëpira të shpëtonim asgjesimit ose të asgjesonim një grup të vogël burrash të vendit, shpesh fqinjët..... Mendova me vete; vallë ky do ishte rezultati i teorive dhe vizionit të luftës së punëtorëve dhe fshatarëve kundër borgjezisë”*. Kurse lëvizjen komuniste, ai e përshkruan kështu: *“Diktatura në fillim është entuziazëm dhe bindje politike të forta, por më vonë kthehet në organizata, karrierizëm dhe autoritete represive”*.

¹³⁸ With Staling against Tito, Banac 1988, pg 81-83).

¹³⁹ Milovan Djilas | Yugoslavian Ēriter and official | Britannica

Le t'i kthehemi situatës në Shqipëri. Me ndihmën e jugosllavëve Hoxha organizoj lëvizjen partizane e cila do të merrte emrin LANÇL. Emri i partizanëve të Titos kishin emër të njëjtë. Grupimet politike të krijuara si rezistence kundër okupatorit ekzistonin, por jo të mirë organizuara në struktura luftarake. Shqipëria në 1942-fillimi i vitit 1943 kishte pamje tjetër, krahasuar me Jugosllavin. Në dukje komunistët dhe Balli Kombëtar operonin në “paqe” në vend, dhe bashkë po luftonin okupatorin. Partizanët dhe Balli Kombëtar kishin më shumë kontroll në jug dhe në Shqipërinë e mesme.

Por, përveç përplasjeve politike, këto dy forca ende nuk ishin përfshirë në luftime vëllavrasëse. Fakti që Shqipëria nuk kishte luftë civile ashtu si në Jugosllavi, u vlerësua si faktor pozitivë. Vetëm mbi këtë bazë britanikët sollën misionin anglezë në ndihmë të luftës.

Kjo situat paqeje nuk zgjati. Pas marrëveshjes së Mukjes mbajtur në gusht të vitit 1943, edhe në Shqipëri vijuan fillimet e luftës civile. Ja si e përkufizon situatën në Ballkan historiani anglez-amerikan, Toni Xhudit (Tony Judt): “*Në Ballkan mbi të gjitha, Lufta e II Botërore, ishte luftë çivile, unike dhe vëllavrasëse*¹⁴⁰”. Pra, mbas gushtit të vitit 1943 Hoxha i vuri qëllim vetes të zhdukte ekzistencën e grupeve politike Balliste-Zogiste ashtu siç veproi Tito me Çetnikët.

¹⁴⁰POSTWAR, Vintage, 2010), Tony Judt, pg. 34.

Le të njihemi me rrethanat e fillimit të luftës civile në Shqipëri. Brigadier Davies ¹⁴¹, përfaqësuesi i misionit anglezë në Shqipëri, i cili mbërriti më tetor të vitit 1943, na sjellë disa informacione rreth takimit me Hoxhën. Hoxha shkruan ai ishte më pak i interesuar në misionin e forcave aleate, por shfaqet tepër i interesuar për politikën ndërkombëtare ¹⁴². Më tej thotë: *“Hoxha ishte i aftë, dhe ishte dikush që mund komandonte pa marrë parasysh humbjet njerëzore”* ¹⁴³. Kurse në lidhje me qëndrimin kundrejt Ballin Kombëtar dhe Legalistëve shkruan ai, Hoxha hapur i shprehet tekstualisht: *“vetëm një gjë mund t’u bëjmë atyre, të shtypim përfundimisht ekzistencën e tyre”* ¹⁴⁴.

Ndërsa, Lenini dhe Bolshevikët filluan luftën civile to mbanin pushtetin, Enver Hoxha filloj luftën civile për të marrë pushtetin.

SHIK-u aktiv gjatë luftës

Më parë duhet të theksojmë se Hoxha personalisht nuk kishte përvojë politike në jetën e tij civile, krahasuar me shumë anëtar të vjetër të grupeve komuniste. Përvoja e tij politike ishte ajo në ilegalitet. Në male, nën udhëzimet dhe këshillat e emisarëve jugosllavë. Pra ai shumë shpejt, u angazhua me asgjësimet politike të rivalëve brenda vetë

¹⁴¹ OBITUARY: Alan Hare | The independent | The independent

¹⁴² Ilyrian Adventure, Brigadier Davies, pg. 76-80.

¹⁴³ Po aty.

¹⁴⁴ Po aty.

PK, kjo kryesisht në mënyrë konspirative. Kurse lufta kundër opozitës tjetër politike, pra, lufta e klasave u deklarua hapur në çdo front. Kështuqë, kemi vendosjen e komisarëve politikë në çdo njësi partizane, të cilët duhet të ishin komunistë. Vetë Hoxha ishte komisar politik i SHIK-ut. Model, ky sovjetik, i kopjuar nga jugosllavët. Vendimet e komisarëve zbatoheshin edhe kur komandantët nuk pajtoheshin. Nëse ishte marrë informacion për “element të rrezikshëm”, skuadra të caktuara viheshin në aksione likuidimi. Këtë metodë politikëbërje, vëllavrasëse dhe fraksioneve vazhdoj edhe pas lufte. Patriotizmi, dija dhe mendimi i lirë nuk kishte vend për lëvizjen komuniste.

Disa shembuj të njohur të eliminimeve politike gjatë luftës

Eliminimet e para ndodhën vetëm pas disa muajve të krijimit të PK e vazhduan deri në vdekjen e Hoxhës¹⁴⁵. U vendos të shkrihej komplet Qarku i Gjirokastrës, se dyshohej se kishte element likuidues¹⁴⁶. Likuidimi i Anastas Lulos vijoj më shpërndarjen e grupit komunist të quajtur “armik” të qarkut të Vlorës, në Maj të 43-shit¹⁴⁷. Me këtë rast KQ i PK nxjerrë një qarkore ku deklaronte: *“Ky pësim duhet të jetë një mësim për të gjitha organizatat e partisë.... Lufta jonë kundër armiqve..... na duhet ti*

¹⁴⁵ Albania and the Balkans, 2013, Bernd Fischer,pg.299).

¹⁴⁶ Historia e PPSH's (Naim Frashëri, 1971 fq. 99).

¹⁴⁷ Po aty, fq. 116

*urrejmë këta njerëz dhe pa mëshirë ti godasim*¹⁴⁸”. Vetëm në paragrafin e mësipërm disa fjalë të tërheqin vëmendjen. Për shembull, “asgjesim, pësim, kundër armiqve, urrejmë, dhe godasim pa mëshirë”. Sinjali i Hoxhës ishte i qartë, pra, thirrje për tolerancë zero ndaj “devijuesve” të linjës së tij politike.

Ndër shembuj të tjerë të dokumentuar po sjellim dy letra për likuidime fizike që ndodhën gjatë 44-ës. Po citoj dy letra të Hoxhës dërguar Nako Spiros¹⁴⁹ në mars të vitit 1944: “.....Për Partinë ska qeder se digjet dhe një dru i njomë me të thatin. S'bëhet ndonjë hata, të mos kenë frikë”. E dyta është e datës 21 shtator 1944 për Llazar Fundon¹⁵⁰ ku jep udhëzime të qarta: “Zai Fundon ta torturoni deri në vdekje dhe ta pushkatoni¹⁵¹”. Duhet nënvizuar togëfjalëshi “Për Partinë ska qeder” dhe “të mos keni frikë”. Këto urdhëra shoqërohen edhe më fjalë inkurajuese nga urdhërdhënësi. Rruga ishte e qartë, çdo eliminim fizik, ishte një hap më afër rreth marjes së pushtetit nga Hoxha.

Verdikti i drejtë historik sot është i lehtë për të arritur. Kjo do të ishte oa dyshim; të gjitha vrasjet për motive politike ishin vrasje me paramendim.

¹⁴⁸ Historia PPSH vol II. Fq..116

¹⁴⁹ Robert Elsie (2012), A Biographical Dictionary of Albanian History, pg. 422–423

¹⁵⁰ Llazar Fundo Biography | HoëOld.co

¹⁵¹ Enver Hoxha, Blendi Fevziu, fq. 77

Metoda represive, e vetmja në duart e Sigurimit

Si dishepull i Stalinit Hoxha është me interes të shohim se sa e çmonte ai vetë punën e organeve represive. Stalini punën e ekzekutorëve e quante “punë e zezë”, por e çmonte duke e trumbetuar atë si diçka sublime për Partinë. Për Hoxhën, për fat të keq nuk kemi as dëshmi, apo dokumenta të tregojnë se si i konsideronte skuadrat ekzekutuese të rivalëve ë tij politikë. Por një gjë është e qartë se Sigurimi ishte mbi të gjithë, por jo mbi partinë. Besnikëria e tij ishte vetëm ndaj partisë. Për fat të keq nuk kemi parë dokumenta dhe nuk kemi emra se cilit ishin ekzekutuesët më të zellshëm në Shqipëri siç kemi emrin e Vasil Blokhinit ¹⁵² në Rusi. Megjithatë, kemi disa informacione të cilët e njohën Hoxhën nga afër. Ja si e përshkruan Mugosha Hoxhën: *“Hoxha nuk ka aftësi administrative. Është person i lëkundur, por ka dhunti për organizimin e proceseve ndëshkimore”*¹⁵³ . .

Një fakt tjetër historikë është i arritjes së Hoxhës në Kongresin e Përmetit, më 22 Maj 1944, me Batalionin e tij Special¹⁵⁴. Pra, Hoxha tashmë kishte nukleusin ushtarak të tij brenda forcave partizane. Kjo ngjarje përkon me atë të krijimit të qeverisë provizore, duke e propoganduar atë si qeveri të unitetit kombëtar, ku në fakt çdo rival politikë u përjashtua. Urrejtja e Hoxhës ndaj klasave “reaksonare”

¹⁵² Vasily Blokhin, history's most prolific executioner - Rare Historical Photos

¹⁵³ <https://youtu.be/jm9kLih3PYë> akses më 25/07/2021

¹⁵⁴ Enver Hoxha, Blendi Fevziu, fq. 114

do përbënte boshtin e punës të Sigurimit. Pra, Hoxha e kishte parë efikasitetin e vrasjeve politike si mjet të vetëm për konsolidim pushtetit personal politik që gjatë luftës.

Kemi edhe fakte të tjera historike të akteve terroriste kryera nga partizanët si dhe nga strukturat komuniste. Keto akte u pranuan nga Hoxha ku bëri në Plenumin e Beratit në nëndor të vitit 1944¹⁵⁵. Por ndërsa ai bënte autokritikë për krimet e kryera gjatë luftës, Mehmet Shehu ishte dërguar në Tiranë, të spastronte qytetin jo nga gjermanët, por nga elementët “reaksonar”. Para se të hynte në Tiranë më 28 Nëntor 1944. Ai arriti të eleminoj totalisht opozitën politike më 1946-ën, me përjashtim të disa grupeve në malet e veriut¹⁵⁶.

Një përmbledhje e situates pas lufte në ballkan na vjen nga Toni Xhudi ku e përshkruan me këto fjale: *“Ashtu si në Rumani dhe Bullgari, Hoxha në Shqipëri mobilizoj komunitetin tosk të jugut kundër rebelimeve klanore të gegëve të veriut, ku nënshtrimi dhe dhuna nuk ishte një nga alternativat tjera por ishte e vetmja rrugë drejt pushtetit*¹⁵⁷”.

Instalimi i terrorit gjysëm shekullor

Panorama e Shqipërisë pas lufte ishte e errët. Vendi trashëgoj varfëri totale. Shoqëria në përgjithësi pas lufte ishte e ç’oreintuar politikisht. Rendi i vjetër i mbretit ishte

¹⁵⁵ Enver Hoxha, Blendi Fevziu, fq. 130

¹⁵⁶ Albania in Transition, Elez Biberaj, pg.21.

¹⁵⁷ Postëar, Tony Judt, pg,135

rrëzuar me pushtimin italian. E vetmja forcë politike prezente në popull ishin forcat partizane. 60.000 burra ushtarë shkruan Musine Kokalari¹⁵⁸ në librin “Si Lindi Partia Social-Demokrate” në letrën dërguar forcave aleate në vitin 1945. Kjo forcë ishte kryesisht burra, e cila përbënte thuasje 5 % të popullsisë. Ja si e përshkruan ajo këtë periudhë pas lufte: *“Mbajtja e një ushtrië kaq të madhe i kushtohet kryesisht faktit se autoritetet kanë frikë që numri i vazhduar i të pakënaqurve mund të përbej rrezik për regjimin”*¹⁵⁹. Pavarësisht popullarizimit që PK pati pas lufte, edhe rezistenca anti-komuniste ishte e madhe. Por, terrori shtetëror nëpërmjet forcave të DMP-s, arriti përfundimisht ta shuante atë.

DMP-ja dhe Sigurimi më vonë ishte kudo. Kjo organizatë në themelet e saj kishte aktivitete ilegale kriminale. Ajo do të ishte për Hoxhën shpata dhe mburoja e tij. Ajo nuk i detyrohej askujt tjetër as edhe ndonjë ministrie tjetër përveç ministri i Ministris së Brendshme. Besnikëria e tyre ishte vetëm ndaj Hoxhës. Si rezultat gëzonin statusin më të lartë dhe tepër special. Dhe nisur nga ky status, dhe nga aktivitetet kriminale të jashtëligjshme që gjatë luftës, nuk kishin asnjë detyrim të respektonin edhe ligjet në fuqi të kohës. Misioni i tyre

¹⁵⁸ Musine Kokalari është e para grua shkrimtare moderne shqiptare. Krijimtaria e saj letrare u pre nga regjimi i Enver Hoxhës kur u dënua me burgim për 20 vjetë më 2 Korrik të vitit 1946.

¹⁵⁹ Musine Kokalari dhe Social Demokracia në Shqipëri, pg. 27

ilegal justifikohet me mbrojtjen e vendit nga “kundër-revolucionarët dhe sabotatorët”.

Terrori i parë i ushtruar ishte ai i Nëndorit të 44-ës ku 137 intelektual u vranë në rrethana të tmerrshme. Ky terror u kpmpletua nga persona ku u hartuan lista të njerëzve të cilët u quajtën “reaksionarë dhe kollaboracionist”. Ky terror ndodhi në situatën ku forca e vetmja e PK, forcat partizane, tashmë me dorë të lirë, do instalonin terror në popull. 137 intelektualët e vranë do shoqëroheshin me mijëra të tjerë ndër vitë. Ky terror shtetëror do ishte aq monstruoz aq sa vetë inisiatorët e donin. Gjyqet speciale do vijonin ku forcat “reaksionare” do ekzekutoheshin ose do kalonin jetën në burgje dhe kampe internimesh. Evidenca në gjyqe, do ishte evidenca e vetme që do kishte peshë, ajo e sjellë nga DMP-ja, ashtu si më vonë do vepronte Sigurimi.

Si rrjedhojë, kemi ngritjen e kampeve të punës së detyruar ku vuajtja njerëzore i kalon masat e një trajtimi edhe çnjerëzor.

Panorama e Shqipërisë nga kjo fushatë persekutimesh

Gjyqet me akuza të sajuara që vijuan në vitet 1945-46 ishin gjyqe për larje hesapesh, hakmarrje dhe llogari politike. Akuzat për kollaboracion ishte një mënyrë tjetër për të eliminuar njerëz me influencë apo grupime politike në popull. Kjo fushatë përndjekjesh u ndërmor të shkatërronte zona të tëra shqiptare ku perceptoheshin si

pengesë për pushtetin komunist. Për shembull, kemi raste kur shumë persona u akuzuan se kishin bashkëpunuar me okupatorin, vetëm mbi bazën se ishin anëtar të BK apo mbështetës jo aktivë, ose mund të ishin thjeshtë simpatizant të italianëve dhe gjermanëve si popuj. Shembuj të klerikëve u përdoqën vetëm sepse kishin influencë në popull.

Arrijmë në konkluzionin se; terrorizimet, arrestimet, internimet, përzëniet nga shtëpitë e tyre, si edhe konfiskimi i pasurisë dhe tokës, dënimet me burg dhe ekzekutimet, ishin padyshim një proces social dhe politik me qëllim të transformimit total të shoqërisë. “*Hoxha si Tito, kërkonte arrestime masive, burgosje dhe ekzekutime, marjen e tokës me forcë*¹⁶⁰,” shkruan Toni Xhud.

Nën regjimin diktatorial komunist, me një organizatë represive si ajo e Sigurimit, njerëzit mësuan dhe u brumosën me mendimin se patriotizmi dhe besnikëria ndaj vendit ishte të poshtëroje dhe mashtroje “të padëshiruarit”, të vidhje, të manipuloje të vërtetën, dhe të reduktoje njeriun në një qenie ku dinjiteti njerëzor quhej nostalgji “mikroborgjeze”. Kjo metodë veprimi tashmë ishte instaluar në ADN-n e shoqërisë.

Pushteti diktatorial komunist me ndihmën e Sigurimit jo vetëm që ishte efektivë në krijimin e “armiqve të popullit”, pra, armiku i brendshëm, por ishte po aq efektivë në krijimin e “armiqve të jashtëm”. Për shembull,

¹⁶⁰ Tony Judt, Postwar, pg, 140

problemet e trashëguara nga shpallja e pavarësisë. Kufijtë shqiptarë ashtu si sot ishin në diskutim ashtu siç kishin qënë nën pushtimin italian dhe atij gjerman. Okupatorët luajtën lojën duke joshur popullsinë lokale me Shqipërinë e Madhe.

Komunistët ishin të pasigurtë, paranojak, dhe urrenin faktin për pozicionin e vendit gjeo-politik në rajon, e atë në arenën ndërkombëtare. Përndjekjet dhe masa represive u morën kundër simpativë reale apo imagjinare për fqinjët grekë apo jugosllav. Pra, në këto kushte, PKSH ishte paranojake duke e krahasuar me të gjitha PK në të gjitha vendet e lindjes. Si rrjedhojë, të gjithë fqinjët, kohë pas kohe, dhe thuajse në mënyrë permanente deklaroheshin armiq. Shtu këtu faktin që numri i armiqve të jashtëm veç shtohet, por urrejtja personale më e madhe e Hoxhës ishte kundër anglezëve dhe amerikanëve.

Mesa kemi parë më sipër, konkludojmë se shërbimi sekret shqiptarë komunist i shërbeu vetëm egos së Enver Hoxhës. Veprimtaria e tij ishte kundër popullit dhe lirive të lindura natyralisht bashkë me vetë individin. Liria e natyrshme ,pra aftësinë për të menduar dhe shprehur mendimin e lirë, do të shtypej me forcë për gjysëm shekulli.

“Inteligjenca” e mbledhur nga Sigurimi nuk kishte për qëllim mbrojtjen e vendit as të rendit. Ndërsa Gjergj Kastriot Skënderbeu, luftoj për 25 vjetë rresht në mesin e shekullit të 15-të kundër një ushtrie të huaj. Enver Hoxha luftoj gjysëm shekulli popullin e vetë. Shqiptarët nuk

kishin njohur ndonjëherë një kërcënim të çdo lirie si ajo nën shpatën e Hoxhës. Nga ana tjetër vendi u shëndërrua në një shoqëri ku çdo mënyrë jetese, tradite, mendimi dhe besimi mijë vjeçar u përmyt forcërisht.

Historia e shërbimit sekret shqiptarë në dorën e Enver Hoxhës duhet të konsiderohet fazë e rëndësishme sepse dëshmon se sa e lehtë është të ndërtohet një shtet totalitar dhe sa e brishtë është demokracia.

Abstract

Sigurimi got it's legitimacy through the partisans who fought the Germans. The partisans came out of war as the only victorious political group. Fortunately, this is supported by evidence, and even by books written by Hoxha himself, party reports, and state archives today. The CP since its first day gave clear instruction how to deal with the dissenters whether imaginary or real. No dissent was to be tolerated. Thus, we can say with confidence; Sigurimi was the only, and the most efficient instrument in the hands of the party. Any dissent meant going back to the old system of "feudal-bourgeois". This is how the party justified to the ordinary people. This gave the party every legal and moral right to repress any dissent. Therefore, Sigurimi were portrayed as heroes. For example, they will fight each day with the counter-revolutionaries, the rich peasants and old bourgeois. This meant liquidating and persecuting whoever was perceived to be on their way. The second form of Sigurimi

oppression was oppressing free thinking. For example, any perceived opinion by them as different to the party, was to be crushed by force. The CP made it clear from the start that they were not the voice of the public opinion. Sigurimi were above all else as the CP, and that was sacred and heavenly. They demanded absolute loyalty from the people. That, meant, people had to denounce anyone who showed a slight of discontent with the government, or lack of supplies, economical and social reforms, or a military resistance. Sigurimi also demanded absolute loyalty of the CP. This sacred power created around itself an impenetrable cordon of guiltlessness. Sigurimi and the CP could not be found guilty of anything. They served by absolute right.

Jetëshkrimi

Universiteti i Drejtësisë Westminster Londër Bachelor. Studime pas universitare për drejtësi. Trajnimet, kryesisht mbi të drejtën për të praktikuar si avokat në gjukatë, intervistimin, dhe këshillimin e klientëve, si edhe prezantime të çështjeve ligjore përpara trupit gjukues.

Studiuese për shkencat shoqërore dhe historinë e vendeve të Europës Jug-lindore.

Punonjëse në departamentin e Emigracionit, Britani

Intervista me azil kërkuesit. Shqyrtimin dhe mbledhje të evidencës nga organizata të miratuara nga Kombet e Bashkuara, BE, SHBA Departament, Amnesty

International për miratim ose refuzim të aplikimeve për azil.

Prezantimi i dokumentave dhe vendimeve të aplikantëve të azilit në gjykatat e Emigracionit.

Asistente prokurore në Prokurorinë e Anglisë, Londer (CPS)

Roli ishte kryesisht mbledhje evidence për çështje kriminale.

Bashkëpunim me policin e Londrës për përgatitjen e çështjeve për të shkuar në gjykatë.

Mbarëvajtjen e viktimave dhe dëshmitarëve në lidhje me evidencën e tyre në gjykatë.

Përpilim relacionesh të prokurorëve, manaxherëve me agjentët e tjerë të prokurorisë angleze në lidhje me cdo etapë të çështjeve penale.